



# TENDERËT KAOTIK TË KOMUNAVE



# TENDERËT KAOTIK TË KOMUNAVE

RAPORT I MONITORIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK  
NË PESË KOMUNA TË KOSOVËS:  
PRISHTINË, PRIZREN, GJILAN, GJAKOVË DHE MAMUSHË

Prishtinë, qershor 2015





|||||

COPYRIGHT © 2014.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 38,  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e EMRI I DONATORIT. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

|||||

## PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	6
DEFINICIONE TË TERMEVE KRYESORE .....	7
HYRJE.....	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	9
REKOMANDIME.....	12
Pse është e rëndësishme të monitorohet prokurimi ?.....	13
ANALIZA E TENDERËVE.....	14
Tenderi për Furnizim me Naftë .....	14
Mirëmbajtja Dimërore e Rrugëve dhe Trotuareve.....	18
Ndërtimi me Kubëza Betoni i Rrugëve dhe Trotuareve .....	20
KOMUNA E PRISHTINËS .....	22
Të dhëna të përgjithshme për prokurimin e Komunës së Prishtinës.....	24
TË GJETURAT E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM .....	25
Kontrata për Furnizim me Naftë .....	26
Tenderi për Ndërtimin e Rrugëve dhe Trotuareve me Kubëza Betoni .....	30
Tenderi për Mirëmbajtjen Dimërore të Rrugëve .....	32
Konkluzione .....	34
KOMUNA E PRIZRENIT .....	35
Të dhëna të Përgjithshme për Prokurimin e Komunës së Prizrenit .....	35
Të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.....	36
Praktikat e Mira.....	37
Tenderi për mirëmbajtjen e rrugëve .....	37
Tenderi për furnizim me naftë.....	39
Tenderi për ndërtimin e rrugës besëlidhja me kubza betoni.....	43
Konkluzionet.....	44
KOMUNA E GJILANIT .....	45
Të dhëna të përgjithshme për prokurimin e Komunës së Gjilanit .....	45
Të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm .....	46
Kontrata për furnizim me derivate për vetura dhe gjeneratorë .....	48
Kontrata për ndërtimin e trotuarit me kubëza betoni.....	50
Kontratë për furnizimin me naftë për ngrohje për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Gjilanit .....	51
Tenderi për mirëmbajtje dimërore të rrugëve në territorin e Komunës së Gjilanit.....	53
Konkluzione .....	56
KOMUNA E GJAKOVËS .....	57
Të dhëna të përgjithshme për prokurimin e Komunës së Gjakovës .....	57
Të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm .....	58
Praktikat e mira .....	60

|||||

Kontrata për Furnizim me Naftë .....	60
Tenderi për ndërtimin me kubëza betoni i rrugëve dhe trotuareve .....	62
Tenderi për Mirëmbajtjen Dimërore të Rrugëve .....	65
Konkluzione .....	67
<b>KOMUNA E MAMUSHËS .....</b>	<b>69</b>
Të dhëna të përgjithshme për Komunën e Mamushës .....	70
Kontrata për Furnizim me Naftë dhe Derivate të Naftës .....	70
Çështje të identifikuara në Kontratë .....	71
Forma e kalkulimit të çmimit për Komunën e Mamushës .....	73
Shtuarja e rrugëve lokale me kubëza të betonit .....	74
Konkluzioni .....	76

|||||

## LISTA E SHKURTESAVE

AKR	Aleanca Kosova e Re
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PIP	Programi i Investimeve Publike
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZTV	Zusätzliche Technische Vorschriften (Rregullorja për kerkësa teknike plotësuese)







|||||

## HYRJE

Në kuadër të monitorimit të prokurimit publik për katër vite në nivelin qendror të qeverisjes në Kosovë, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar një numër të madh të raporteve dhe të gjeturave në fushën e prokurimit publik në Kosovë. Shumë nga këto raste kanë pasur elemente të veprave penale të cilat lidhen me korrupsionin dhe keq menaxhimin e parasë publike. Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në këtë sektor, KDI ka vazhduar të zgjerojë numrin e institucioneve të cilat i ka mbikëqyrur në procedurat e prokurimit publik.

Në vitin 2014 KDI ka filluar iniciativën e monitorimit të pesë komunave në Kosovë, institucione këto që reflektojnë përbërje të ndryshme politike. Në secilën prej tyre janë përzgjedhur nga tre tenderë specifikë të cilët janë monitoruar e që janë bazë e këtij studimi krahasues. Kjo është bërë për qëllim që të dhënat për të njëjtit tenderë të mund të krahasohen në mes vete, në lidhje me efikasitetin që kanë pasur komunat në shpenzimin e buxhetit që kanë nën menaxhim. Tre tenderët e analizuar në secilën prej pesë komunave përshijnë: tenderët e furnizimit me naftë dhe derivate, mirëmbajtjen dimërore të rrugëve dhe shtrimin e rrugëve me kubëza të betonit.

Prokurimi publik në Kosovë karakterizohet nga një numër i madh i problemeve të cilat kryesisht lidhen me favorizimin e bizneseve në dhënien e kontratave, çmimet jo normale të cilat nuk korrespondojnë me vlerën e artikujve në treg dhe mbikëqyrjen e dobët të kontratave që rezultojnë me cilësi të dobët të shërbimeve dhe furnizimeve për institucionet. Prokurimi po ashtu është shumë i përfolur si sektor i korruptuar, të cilit institucionet e ndjekjes nuk i kushtojnë ndonjë vëmendje të posaçme, kryesisht me arsyetimin se zyrtarët publik nuk e njohin këtë ligj dhe Prokuroria nuk është e aftë të hetojë korrupsionin në këtë sektor.

Në këtë raport u është kushtuar vëmendje edhe gjetjeve që institucionet mbikëqyrëse kanë bërë për këto organizata buxhetore. Një numër i madh i institucioneve kanë rol mbikëqyrës në prokurimin publik, andaj ka qenë shumë me interes të shihet se cilat janë rezultat e këtyre institucioneve në mbikëqyrjen e prokurimit publik dhe parandalimin e shpenzimeve në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, është organi kryesor i monitorimit të procedurave të prokurimit, madje edhe zbatimit të kontratave nga autoritet kontraktuese. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm gjithashtu auditon të gjitha autoritetet kontraktuese dhe në këtë raport i është kushtuar një vëmendje e madhe të gjeturave të ZAP në fushën e prokurimit publik, për të gjitha komunat e monitoruara.

|||||







|||||

## *PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË MONITOROHET PROKURIMI ?*

Çdo vit institucionet shpenzojnë më tepër se gjysmën e buxhetit të shtetit në investime kapitale dhe shërbime. Nga ndërtimi i rrugëve dhe shkollave e deri tek furnizimi me barna për institucionet shëndetësore, këto kontrata lidhen përmes procedurave të prokurimit. Vlerat e tenderëve zakonisht janë të larta dhe duke u bazuar në peshën që ka sektori publik mbi atë privat, shpesh herë krijohen raporte të ngushta në mes biznesmenëve dhe përfaqësuesve të institucioneve. Kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe vëllimin e shërbimeve që mund të ofrojnë institucionet për qytetarët.

Monitorimi i prokurimit publik nga sektori jo qeveritarë mundëson që në shumë raste korrupsioni të parandalohet përmes reagimeve qytetare, apo në rastet kur një vepër korrupsioni ka ndodhur e njëjta të ndëshkohet. KDI monitoron tender specifik me qëllim të identifikimit të rreziqeve, për të avokuar në lidhje me ndryshime dhe reforma strukturore. Në rastet kur identifikohen dëmtime materiale të buxhetit, informatat nga raportet përcillen në prokurorinë e shtetit. Një monitorim efektiv i prokurimit mund të ketë dobi të shumta për publikun dhe vet sektorin e biznesit, kjo për shkak se rrit efikasitetin e institucionit dhe ndihmon në krijimin e konkurrencës së drejtë në marrjen e kontratave publike.

|||||



|||||

euro vlera më e lartë, varësisht nga kompanitë. Vetë vlera e transportit të naftës, ndikon në çmimin përfundimtarë të këtij artikulli. Vlera e transportit të naftës nuk është pjesë e vlerësimit të tenderit, andaj nga monitorimi kemi vërejtur se kjo gjë mund të përdoret nga operatorët ekonomik për të ngritur vlerën e çmimit të karburanteve, pasi që ato e kalkulojnë me vlera të ndryshme, si pasojë e mos kontrollit nga autoritetet kontraktuese.

Çmimi i premiumit të naftës, po ashtu është një çështje e cila duhet t'i kushtohet vëmendje pasi i njëjti është shumë i ndryshëm, varësisht nga komuna që kemi monitoruar. Nga katër komunat të cilat kanë pasur kontratë me Premium, kemi vërejtur se çmimet janë thellësisht të ndryshme. Në

*Në rastin e Komunës së Gjilanit, komuna duhet të blej 10 000 litra naftë, në mënyrë që kompania të fitoj 1 euro*

rastin më të keq, dy komuna të mëdha të Kosovës, të cilat furnizohen nga i njëjti operator ekonomik, Petrol Company kanë pasur çmimet shumë të ndryshme. Në komunën e Gjilanit, çmimi për premium është 0.0001 euro për litër, ndërsa në atë të Prizrenit 0.15 euro për litër. Të dy këto vlera të premieeve janë të pa pranueshme, pasi të njëjtat bëjnë që çmimet e naftës për litër në rastin e parë të jenë shumë të ulëta dhe në të dytin ato kalojnë vlerën e naftës në tregun me pakicë. Në rastin e Gjilanit, komuna duhet të blejë 10,000 litra naftë në mënyrë kompania të fitoj vetëm një euro. Në këtë rast komuna duhet të ketë kujdes një varg problemesh që mund të rrjedhin nga kjo kontratë, siç është mashtrimi me çmimin mesatar të naftës, kualiteti i naftës, sasia, etj. Kjo pasi që asnjë kompani nuk do të transportonte 10,000 litra naftë vetëm për të fituar një euro.

Në anën tjetër Prizreni, paguan 0.15 euro premium për një litër naftë të njëjtit operator. Ky çmim është shumë fish më i lartë sesa mesatarja e premiumit në Kosovë dhe që rezulton me çmim më të lartë sesa vlera e artikullit në tregun me pakicë. Dilema mbesin në faktin se pse ka ardhur deri tek një çmim kaq i lartë një komunë e madhe e cila harxhon më shumë në sasi të karburanteve sesa të gjitha komunat e tjera me përjashtim të Prishtinës. Po ashtu dilemë tjetër është se si është e mundur që e njëjta të mos merr një ofertë më të mirë sesa komunat e tjera, për më keq paguan çmimin më të lartë në krahasim me gati të gjitha komunat e Kosovës të cilat kanë të publikuar çmimin e premiumit. Çmim më të lartë sesa Prizreni ka vetëm Podujeva 0.60 euro, çmim i cili më së shumti do të duhej t'i shërbente prokurorisë për ta trajtuar.

|||||





|||||

nuk janë caktuar sasinë e përafërta të nevojave, nuk janë ndarë artikujt në lloje, për t'u siguruar që komuna të marr çmimin sa më të favorshëm për naftën. Komuna të tilla që nuk kanë përcaktuar sasinë, kanë qenë Prizreni, Gjakova dhe Mamusha.

KRPP vlerësohet të jetë institucioni që ka përgjegjësinë kryesore për kaosin ekzistues në fushën e prokurimit të naftës. Roli i këtij institucioni para se gjithash është nxjerrja e rregulloreve dhe udhëzuesve për t'u dhënë përgjigje sfidave në procesin e prokurimit dhe për të ruajtur parandë publike dhe konkurrencën e drejtë ndërmjet operatorëve ekonomik. Ky institucion nuk ka nxjerr asnjë rregullorë në këtë drejtim, përkundër se është në dijeni të këtij problemi, madje disa zyrtar të prokurimit dhe të kompanive private janë ngarkuar me aktakuza të prokurorisë për dëmtim të buxhetit.<sup>3</sup> KRPP do të duhej që të ndërhynte në këtë lloj të tenderëve, duke përcaktuar formën e tenderimit, hartimin e kontratave kornizë, kalkulimin e çmimit, si dhe të monitoronte institucionet në këtë fushë të tenderëve, pasi që nafta është një nga artikujt që shpenzohet më së shumti në prokurim publik.

*Institucionet rregullatorë nuk u ofrojnë komunave qasje në çmimet e karburanteve. Komunat bazohen vetëm në dokumentet që sjellin kompanitë private*

KRPP do të mund të rregullonte formën e tenderimit, duke përcaktuar një standard i cili do të ishte i aplikueshëm nga të gjitha institucionet, duke përfshirë edhe AQP-në e cila ka tenderuar në emër të 37 institucioneve publike, me formën e premiumit. Duke zgjedhur praktikën më të mirë të tenderimit të karburanteve dhe veçanërisht naftës, do të shmangte praktikat e gabueshme dhe të dëmshme të mos përcaktimit të sasive, përzierjes së artikujve etj. Po ashtu ky institucion duhet që të siguroj që komunat të kenë qasje në çmimin e naftës në berzën ndërkombëtare. Kjo mund të bëhet duke e ngritur bashkëpunimin me KRPP, Doganën apo AQP-në të cilat aktualisht kanë qasje në këtë çmim të berzës. KRPP në kërkesat e institucioneve për të interpretuar Ligjin e Prokurimit në çështjet e çmimeve jo normalisht të ulëta dhe çështje të tjera që lidhen me naftën, i ka ikur përgjegjësisë ligjore që ka aktualisht dhe ka shërbyer negativisht në mbrojtjen e parasë publike dhe konkurrencës në sektorin e prokurimit. KRPP do të duhej në këtë çështje të jap tre përgjigje; e para cila është forma që duhet tenderohet nafta, me premium bazuar në cilën berzë, e dyta cili është çmimi jo normalisht i ulët, pragu nën të cilin nuk duhet të merren parasysh ofertat dhe çështja e tretë si duhet të paguhet transportimi i naftës, për të shmangur problemet me fryrjen e këtij çmimi.

<sup>3</sup> Rasti tenderit të Policisë së Kosovës, në tenderin për furnizim me naftë i vitit 2011. <http://gazetajn.com/?cid=1,1018,411>

|||||



|||||

Komuna e Gjakovës, ka lidhur kontratë me dy operatorë ekonomik për mirëmbajtjen e rrugëve. Dosja e tenderit, në të cilën nuk janë përcaktuar kërkesat minimale teknike dhe profesionale, ka lënë shumë hapësirë për operatorët e pa përgjegjshëm për të aplikuar dhe mbase fituar kontratën. Në dosjen e tenderit, nuk janë përcaktuar kërkesat minimale teknike dhe profesionale. Një operator ka mundur që me një numër minimal, madje të pa përcaktuar të pajisjeve të aplikoj dhe fitoj tenderin e Komunës për mirëmbajtjen e rrugëve. Komuna nuk ka përcaktuar cilat pajisje duhet t'i ketë në pronësi ose shfrytëzim një kompani për t'u konsideruar e përgjegjshme dhe për më tepër nuk ka përcaktuar çfarë stafi duhet të ketë një kompani, për shembull minimumi prej 15 apo 20 punëtorë. Gjakova ka paguar çmimin më të lartë për një ndërhyrje, kjo pasi që kompania Çabрати është paguar me 75 euro për një ndërhyrje me hedhje të kripës, për një KM<sup>1</sup>. Çmimet tejet të larta të Gjakovës kanë qenë një ndër problemet më të mëdha në këtë komunë.


Komuna e Prishtinës ka aplikuar formë të pa favorshme të kontratës, pasi që ka paraparë që pagesat të bëhen të përmbledhura për të gjitha punët e kontraktuara, duke mos e lënë mundësinë e pagesës për njësi. Kjo e ka bërë të vështirë monitorimin e zbatimit të kontratave dhe sidomos pagesat e pjeshme të kompanive. Në çdo rast kur punët nuk janë kryer në përputhje me kontratën apo në tërësinë e tyre, komuna nuk ka mundur të aplikoj gjoba pasi që kontrata ka pasur të përmbledhura të gjitha çmimet.

Edhe në mirëmbajtjen e rrugëve, ngjashëm me tenderët për karburante, KRPP nuk ka vendosur ndonjë standard për formën e kontratave, dosjes së tenderit dhe çështje të tjera të cilat përcjellin si sfida komunat. KRPP është institucion i cili do të duhej të përcaktonte standarde në këtë tender, për t'i lehtësuar zyrtarëve të prokurimit dhe komunave të bëjnë procedurat e tenderit. Kjo madje do t'i ndihmonte edhe vet kompanitë, të cilat varësisht nga institucioni ku aplikojnë përballen me forma shumë të ndryshme të dosjeve të tenderëve dhe kërkesave. Llogaritja e çmimeve, po ashtu duhet të harmonizohet në mënyrën e cila do të konsiderohej si më e sakta dhe me qëllim të uniformimit të të gjitha komunave dhe institucioneve. Problemet të ngjashme përcjellin edhe tenderët e MI-së, e cila shumë shpesh ndërron numrin e llojeve apo pjesëve të kontratës, harton paramasa të ndryshme dhe kjo për shkak të mungesës së mbikëqyrjes së KRPP-së e cila do të mund të vinte rregull në këtë sektor të tenderëve edhe duke u bazuar në praktikat ndërkombëtare.


|||||







## ÇMIMI I KUBËZAVE









|||||

## *TË GJETURAT E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM*

Në raportin e fundit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) për komunën e Prishtinës, numri i të gjeturave në fushën e prokurimit publik ka qenë i mangët. ZAP ka dhënë disa vërejtje në këtë fushë, mirëpo në krahasim me buxhetin e institucionit, këto vërejtje lirisht mund të cilësohen si të vogla.

Në pesë projekte kapitale: “Ndërtimi i rreth rrotullimit në dalje të Prishtinës - drejtimi i Veternikut”, “Sheshi i Pavarësisë - Ibrahim Rugova dhe Sheshi Zahir Pajaziti”, “Rindërtimi i rrugëve në lagjen Mati, grupi II” , ndërtimi i rrugës “Malush Kosova” dhe mbikalimi te shkallët në lagjen “Arbëria”, kishte vonesa në ekzekutimin e punëve. Për më tepër, Komuna nuk kishte aplikuar ndëshkime që parashihen me dispozitat kontraktuale.

Projekti për ndërtimin e shkollës fillore në Lagjen Arbëria (bazuar në kontratën e datës 30.12.2009 me vlerë prej 656,948€) ishte ndërprerë në vitin 2012 për shkak të kontestit pronësor, pasi ishin paguar 420,000€. Në fillim të vitit 2013, po për këtë projekt është nënshkruar një kontratë e re në vlerë 737,832€ por pas pagesës së situacionit të parë prej 47,143€ u ndërpre punimet si pasojë e motit të keq. Më pastaj, Gjykata Themelore e Prishtinës ka caktuar masën e ndalimit të kryerjes së punimeve për shkak të kontestit pronësor; një kompensim prej gjithsej 200,000€ është pretenduar nga pronari i tokës. Përkundër shpenzimit të mjeteve të komunës në vlerë prej 467,143€ ky projekt vazhdon të jetë i pezulluar.

Te kontrata për furnizim me dy Autoambulanca për nevoja të Qendrës së Mjekësisë familjare, automjetet nuk janë pranuar. Pas skadimit të sigurimit të ekzekutimit, operatori në mënyrë të njëanshme e ka ndërprerë kontratën dhe komuna nuk ishte në gjendje të konfiskoj sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 5,788€

|||||

## KONTRATA PËR FURNIZIM ME NAFTË

Furnizimi me naftë i Komunës së Prishtinës ka pasur disa probleme, që kur qeverisja e re e Prishtinës i ka ndërprerë kontratën operatorit ekonomik Hib Petrol me arsyetimin e mashtrimit me cilësi të naftës, e cila përdorej për ngrohjen e shkollave. Komuna ka shpallur tender në vitin 2014<sup>9</sup>, për të përzgjedhur operatorin tjetër ekonomik për të lidhur kontratë për furnizim me naftë. Përkundër një procesi tenderues me katër oferta, sërish janë paraqitur sfida në rrjedhën e procesit deri në nënshkrimin e kontratës. Njëra nga to ishte botimi i një artikulli në të përditshmen Koha Ditore<sup>10</sup>, në të cilin sfidoheshin licencat e kompanisë së rekomanduar për dhënie të kontratës, Petrol Company. Verifikimi i dokumenteve të dorëzuara në oferta është i pamundur të bëhet për secilën kompani dhe për çdo rast. Përjashtim bëjnë dokumentet për të cilat ka dyshime apo për të cilat ndonjë nga operatorët ka parashtruar ankesë. Komuna e Prishtinës, për dallim nga të gjitha komunat e tjera ka mënyrë tjetër të tenderimit të naftës dhe njëkohësisht ka dy kontrata për të njëjtin artikull. Në këtë raport është analizuar kontrata kryesore, dhënë kompanisë Petrol Company.<sup>11</sup>

Një nga kriteret në dosjen e tenderit, kërkon që kompania konkurrese duhet të posedojë me rezerva të naftës në rast të krizës eventuale me furnizim dhe ky është një indikator që komuna ka aplikuar një kriter diskriminues për operatorët më të vegjël. Po ashtu çmimi i vajrave motorike është shumë i ulët dhe rrezikon që komuna të furnizohet me vajra jo cilësore, që më pas do të përkthejë në shpenzime shtesë për sanimin e dëmeve që do të shkaktonte në veturat zyrtare.

Siç edhe u cek më lart, Prishtina, krahasuar me komunat tjera ka adaptuar një formë tjetër të tenderimit të naftës. Nafta tenderohet me çmim fiks, dhe kompanitë nuk paraqesin çmimin e premiumit, por çmimin total të furnizimit. Qëllimi i kësaj është që të dihet saktë çmimi i litrit për naftë. Në anën tjetër për të balancuar ndryshimet e çmimit të naftës me berzë, komuna ka vendosur rregullin e mini-konkurrencës, ku të gjithë operatorët e përgjegjshëm në këtë tender kërkojnë të ofertojnë sa herë që ka ndryshime të çmimit në +2% apo -2%. Në të gjitha këto raste, tre kompanitë e përgjegjshme paraqesin ofertat e tyre, dhe kjo bëhet në një afat më të shpejtë dhe me përfitime të dyanshme: komunës i mundëson furnizim me çmime më të favorshme, ndërsa operatorëve mundësi më të mëdha për konkurrim.

KDI vlerëson që komuna e Prishtinës ka vendosur kriter i cili ka diskriminuar disa kompani. Operatorët e përgjegjshëm kërkojnë që të mbajnë në stok 100 000 litra naftë dhe 10 000 litra benzinë si rezerva për nevojat e komunës në rast të krizave në furnizim me karburante.<sup>12</sup> Komuna mbase ka pasur qëllim të mirë që të sigurohet në rast të krizave në furnizime, mirëpo

<sup>9</sup> Njoftimi për kontratë i datës 14 korrik 2014

<sup>10</sup> Koha Ditore, Prishtina shpërblen me tender kompaninë falsifikatore, Besnik Krasniqi, 29 gusht 2014

<sup>11</sup> Procedura e prokurimit me numër PR616-14-059-1-1-1

<sup>12</sup> Dosja e tenderit nr. PR616-14-059-1-1-1, pjesa e kritereve teknike

|||||

kjo formë e kontratës nuk garanton se në një rast të tillë kompania do t'i ofroj këto rezerva për komunën. KDI vlerëson se vendosja e këtij kriteri është e panevojshme dhe mund të dëmtojë konkurrencën, pasi që shumë operatorë të interesuar, e veçanërisht ata më të vegjël mund të dekurajohen për ofertim, në pamundësi për të përmbushur këtë kriter. Nëse komuna dëshiron të mbrohet nga krizat eventuale në furnizim me karburante, ajo eventualisht mund të ndërtojë kapacitetet e saja për rezerva të naftës dhe benzinës. Në rastet kur edhe mund të paraqiten krizat eventuale të furnizimit me naftë, kjo formë e kontratës me variacione të çmimeve prej +/- 2%, obligon ri përsëritjen e tenderimit; në rrethana të tilla, kompanitë mund të mos ofertojnë dhe t'i shmangen obligimit për ta furnizuar komunën në kohë krizash.

Një operator ekonomik, Graniti Petrol është ankuar në OSHP për këtë kriter të komunës<sup>13</sup>, mirëpo pas marrjes së raportit të ekspertit, ai ka tërhequr ankesën për të mos vazhduar procesin. Në këtë formë ai nuk ka rrezikuar depozitën e 500 eurove që operatorët paguajnë për një ankesë, mirëpo nuk ka provuar të dërgojë ankesën deri në shqyrtimin përfundimtar të panelit të OSHP-së. Në bazë të këtij raporti të ekspertit të OSHP-së, që më pas është shndërruar në konkluzion të institucionit, ky kriter nuk ka qenë diskriminues.<sup>14</sup> Arsyetimi i ekspertit për këtë çështje është se në Kosovë, ekzistojnë gjithsejtë 14 operatorë të licencuar për të pasur depozita të karburanteve. Sidoqoftë numri i operatorëve të interesuar për këtë tender ishte vetëm katër, prej të cilëve një ishte i pa përgjegjshëm.<sup>15</sup> Kjo tregon më së miri se ky kriter ka ndikuar që të ulet ndjeshëm konkurrenca në këtë tender dhe rrjedhimisht, ky kriter i ka diskriminuar operatorët më të vegjël në treg. Këta operatorë do të mund ta furnizonin komunën, pasi që nuk është ndonjë institucion i cili shpenzon shumë derivate.

Në mënyrë që të mundësohet kontrolli i cilësisë dhe çmimit të naftës dhe rrjedhimisht të garantohet cilësia e saj, Komuna e Prishtinës ka bërë disa hapa pozitivë. Ajo ka paraparë një numër të madh të kushteve në dosjen e tenderit. Ndër to është që pavarësisht procedurave tenderuese komuna nuk do t'i paguaj në asnjë rrethanë operatorit ekonomik çmim më të lartë për litër të naftës nga çmimi në tregun me pakicë, pra mesataren e tregut apo edhe të vet operatorit i cili bënë furnizimin. Kjo ka ndikuar pozitivisht që komuna të jetë e mbrojtur nga çmimi i lartë, i cili madje tejkalon çmimin e litrit të naftës në tregun me pakicë, siç ndodhë në komunat: Mamushë, Prizren dhe Gjakovë. Këto komuna paguajnë një litër naftë për disa centë më shtrenjtë sesa kushton një litër naftë në tregun me pakicë.

<sup>13</sup> Ankesa e operatorit Graniti Petrol, e dates 30 qershor 2014, numër 216/14

<sup>14</sup> Konkluzioni i OSHP I dates 25 korrik 2014, me numër 216/14, <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2014/Furniz-me-nafte-per-nev-komune.pdf>

<sup>15</sup> Raporti i vlerësimit të tenderëve për furnizim me naftë dhe derivate me numër 616-14-059-111

|||||



|||||

me 2 euro për litër, e që realisht kjo nuk garanton asnjë standard të cilësisë. Vajrat motorike kanë çmime nga 5-9 euro në mesatare varësisht nga cilësia dhe prodhuesit. Në këtë rast komuna mund të dëmtohet nga cilësia e këtij artikulli, pasi që vajrat e cilësisë së dobët mund të ndikojnë në rritjen e nevojës për servise dhe dëmtimin e automjeteve të cilat indirekt ngritin shpenzimet e komunës. Arsyetimi i Komunës për këtë çështje është se kanë edhe një kontratë tjetër në të cilën janë kontraktuar shërbimet e servisit të automjeteve, që rrjedhimisht është problem i dyfishtë, pasi i njëjti artikull nuk mund të jetë objekt i dy kontratave apo procedurave të ndryshme.

Komuna e Prishtinës është përballur me ankesë nga Kompani Hib Petrol, në lidhje me tenderin për furnizim me naftë. Kompania është ankuar pasi që në procedurën e vlerësimit të ofertave është shpallur si e pa përgjegjshme, pikërisht për shkak të kontratës paraprake në lidhje furnizim me naftë për shkollat e Prishtinës. Për shkak të pretendimit për mashtrim me cilësinë e naftës, Komuna i ka ndërprerë këtë kontratë kësaj kompanie. Në tenderin e ri, kjo kompani ka aplikuar përsëri, ndërsa Komuna nuk e ka marrë në konsideratë aplikimin, mu për shkak të pretendimeve se e njëjta ka mashtruar në cilësinë e karburanteve. Sidoqoftë në OSHP Hib Petrol ka fituar rastin dhe Komuna është urdhëruar që tenderin ta kthejë në rivlerësim.<sup>18</sup> Komuna e Prishtinës në procedurën e ri vlerësimit ka vepruar në të njëjtën mënyrë dhe ka shpallur të pa përgjegjshëm operatorin, i cili sërisht është ankuar.<sup>19</sup> Herën e dytë komuna i ka ofruar më shumë prova materiale panelit dhe ekspertit shqyrtues, duke kthyer rastin në favor të saj<sup>20</sup>. Sidoqoftë nëse komuna do të pranonte si të përgjegjshme këtë kompani, do të vinte në dyshim procedurën paraprake të ndërprerjes së kontratës, pasi që një operator për të cilin komuna pretendon të ketë mashtruar me cilësi, nuk mund të shpërblehet edhe me një kontratë shtesë.

<sup>18</sup>Vendimi i OSHP 453/14, i datës 12 dhjetor 2014

<sup>19</sup>Raporti i vlerësimit të tenderëve për furnizim me naftë dhe derivate me numër 616-14-059-111

<sup>20</sup>Vendimi i OSHP 47/15, i datës 12 mars 2015

|||||



|||||

as nuk i njohin këto standarde. Për më tepër ato nuk janë të përkthyer në gjuhët lokale dhe krahasuar me qytetet e tjera të Kosovës, apo institucionet qendrore të cilat kemi monitoruar, asnjëherë nuk janë kërkuar si pjesë e dosjes në këtë formë. Konsiderojmë se Komuna në tenderët e tjerë duhet të kufizohet nga kërkesat e tilla të cilat mund të paraqesin probleme për kompanitë kosovare. Standardet e cilësisë mund të kërkojnë edhe me dosjen e tenderit dhe testimet e nevojshme të cilat mund t'u bëhen kualitetit të punëve që kryhet në terren.

Problemi i dytë në këtë tender janë çmimet e kubëzave të betonit. KDI vlerëson se këto çmime janë shumë të lira. Kontrata tregon se çmimet varësisht nga rruga janë 7 ose 8 euro për m<sup>2</sup>.<sup>23</sup> Një çmim i tillë nuk garanton kualitet, sepse është i përafërt me koston e prodhimit të kubëzave. Punët dhe materialet përcjellëse për vendosjen e këtyre kubëzave nuk mbulohen nga këto çmime të ulëta. Sipas vlerësimeve dhe konsultave që KDI ka pasur me disa punëkryes dhe sipas vlerave të tregut në me pakicë në Kosovë, kubëzat e betonit mund të vendosen prej 10 deri 13 euro për M<sup>2</sup> dhe çdo çmim tjetër duhet mbikëqyrur me kujdes, pasi që zakonisht rezulton me punë të dobëta. Komuna në këtë rast ka pasur dy opsione: të ngrit vlerën e sigurimit të ekzekutimit të punëve, apo të trajtoj tenderin si të pa përgjegjshëm për shkak të çmimeve shumë të lira. Është e pritshme që operatori ekonomik me këto çmime do të ketë probleme në ekzekutimin e punimeve, do të sakrifikoj cilësinë dhe potencialisht do të kërkojë kontratë shtesë. Për të shmangur këto probleme Komuna është dashur të aplikojë ngritjen e sigurisë së tenderit, e cila edhe është parashikuar në dosje të tenderit. Kjo do të ishte një garanci për komunën që punët në terren do të kryeshin në përputhje me cilësinë e kërkuar.

Përveç kubëzave të betonit, çmim të ulët në raport me çmimet e tregut ka edhe tek kapakët së bashku me konus, të cilat janë paraparë të përballojnë peshën deri në 40 tonë. Çmimi për njësi i ofruar nga operatori ekonomik është 60 euro. Sipas konsultimeve me bizneset, çmimet e tregut për këta artikujt janë dukshëm më të larta. Kapakët e kualitetit të tillë duke mos përfshirë konusin kushtojnë deri në 120 euro dhe kur kësaj i shtohet çmime prej 20 euro për konus, vlera mesatare arrin 140 euro.<sup>24</sup> Shpërputhja me çmimin e ofertuar është e madhe, andaj edhe komuna do të duhej që bazuar në këto të dhëna, të rrisë mbikëqyrjen e punimeve dhe eventualisht të ketë parasysh masat e tjera të nevojshme për t'u siguruar se të njëjtit artikuj do të vendosen të kualitetit të kërkuar dhe në sasinë i cili është paraparë në projekt.

<sup>23</sup>Kontrata e Komunës së Prishtinës me operatorin Dimi-Bau, me numër 616 14155 521

<sup>24</sup>Në lidhje e vlerën e artikujve të tenderëve, KDI ka zhvilluar konsultime me disa biznese të cilat në kushte të anonimitetit kanë ofruar informacione në lidhje me problemet e çmimeve për njësi si dhe shpërputhjen e tyre me çmimet reale të tregut

|||||





|||||

ndërprerje të kontratës me arsyen e mungesës së efikasitetit në pastrimin e rrugëve nga bora, mirëpo asnjëherë nuk u janë ndalur pagesat për rrugët e pa pastruara. Kjo është e pa pranueshme, për shkakun se kompanitë në këtë formë shpërblehen për punën të cilën nuk e kanë bërë.

Komunat e tjera si Gjilani, Prizreni dhe Gjakova, paguajnë kompanitë e tilla bazuar në sasinë e punëve të kryera dhe jo për totalin e rrugëve të kontraktuara. Me këtë kontratë Komuna e Prishtinës nuk ka bërë zgjidhje të mirë për pagesën e kompanive. Kjo pasi që i ka hequr një mundësi të përshtatshme vetës që në përputhje me monitorimin e punëve në teren, të paguaj kompanitë vetëm për rrugët të cilat janë pastruar dhe jo më tepër. Sidoqoftë komuna ka bërë mirë kur ka ndarë tenderin në katër lloje, me çka ka shpërndarë më mirë punët në operatorë të ndryshëm dhe në këtë formë ka rritur mundësinë për të pasur rrugët më të pastruara nga bora. Në komunat e tjera ndarja në lloje shpesh herë më shumë i është përshtatur nevojave të kompanive private, për të ndarë kontratat proporcionalisht, sesa vetë nevojave dhe specifikave të qytetit.

Problem tjetër i kësaj kontrate ka qenë mos efikasiteti i kompanive në pastrimin e rrugëve nga bora në disa raste kur kishte më shumë të reshura. Komuna e Prishtinës, është përballur me mos efikasitetin e kompanive për të pastruar rrugët nga bora.<sup>27</sup> Në disa raste shumë rrugë kanë pritur që moti të përmirësohet për t'u shkrirë, pasi që ka munguar pastrimi dhe hedhja e kripës. Rëndësi më e madhe i është kushtuar rrugëve kryesore të qytetit, mirëpo në të njëjtën kohë kompanitë janë paguar për të bërë pastrimin e të gjitha rrugëve. Situata edhe më e keqe ka qenë pastrimi i trotuareve nga bora, ku shumica e tyre ose janë pastruar nga persona privat ose nuk janë pastruar fare nga bora dhe kompanitë shumë më pak i kanë kushtuar vëmendje kësaj kategorie të kontratës.<sup>28</sup> Pastrimi i trotuareve ka qenë pjesë përbërëse e kontratës dhe kompanitë kanë pasur obligim që ta bëjnë këtë.

Çështja e tretë në këtë tender është mos shpërblimi i kompanisë Zahiri me tre kontrata ashtu siç edhe kishte dalë oferta më e lirë. Sidoqoftë komuna ka paraparë minimumin e pajisjeve dhe stafit që duhet të ketë një kompani për të fituar një kontratë dhe ky operator për shkak të mos posedimit të këtyre resurseve është dashur të kufizohet me një kontratë të vetme. Për dallim nga të gjitha komunat e tjera të cilat kemi monitoruar, Prishtina i ka kushtuar më së shumti vëmendje kapaciteteve teknike dhe profesionale të kompanive, duke u kërkuar një minimum të caktuar të pajisjeve dhe stafit. Dallimi është më drastik me Komunën e Gjakovës e cila në fakt nuk u ka kërkuar asgjë kompanive, vetëm se ka përmendur se kompanitë duhet të kenë pajisje dhe referenca. Sidoqoftë as kjo duket të mos ketë mjaftuar, numri i pajisjeve, stafi dhe vet ndarja në katër lloje, pasi që përkundër të gjitha këtyre masave, efikasiteti prapëseprapë ka qenë i dobët. Kjo do të duhej që komunës t'i shërbej si mësim për lidhjen e kontratave në të ardhmen, për të

<sup>27</sup> Koha Ditore, Prishtina fajëson kompanitë për rrugët e papastruara nga bora, 15 janar 2015

<sup>28</sup> Gazeta Jeta në Kosovë, Bora paralizon vendin, Bujar Aruqaj, 26 janar 2015

|||||

pasur parasysh, ndarjen edhe më të madhe në lloje dhe për të kërkuar më tepër pajisje nga kompanitë të cilat do të ofertojnë.

## KONKLUZIONE

- Në tenderin për furnizim me naftë, Komuna e Prishtinës ka aplikuar kritere diskriminuese për kompanitë më të vogla;
- Në tenderin për shtrimin e rrugëve me kubëza betoni, Komuna ka kërkuar zbatimin e rregullores gjermane ZTV e cila nuk është e aplikueshme me asnjë ligj apo rregullore në Kosovë;
- Në tenderin për shtrimin e rrugëve me kubëza të betonit, komuna ka lidhur kontratë me një operator i cili ka çmime më të lira sesa çmimi i tregut (jo normalisht të ulëta);
- Në tenderin për mirëmbajtjen e rrugëve, Komuna e Prishtinës nuk ka detajuar paramasat dhe çmimet për njësi dhe i ka vështirësuar vetës mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre kontratave;
- Në tenderin e mirëmbajtjes së rrugëve, Komuna është ballafaquar me mos efikasitet të kompanive për pastrimin e rrugëve nga bora.
- Monitorimi i zbatimit të kontratave në Komunën e Prishtinës është jo efikas, sidomos në çështjet e ndaljes së pagesave për kompanitë të cilat nuk kanë kryer punët në përputhje me kontratat.



## KOMUNA E PRIZRENIT



### *TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROKURIMIN E KOMUNËS SË PRIZRENIT*

Komuna e Prizrenit është komuna me buxhetin më të lartë në Kosovë, pas Komunës së Prishtinës. Prizreni ka një buxhet të përgjithshëm prej 35,877,659. Prej këtyre mjeteve, 15,841,983





|||||

Në anën tjetër komuna e Prizrenit nuk ka qenë edhe aq komode me numrin e ankesave që janë dorëzuar nga bizneset në OSHP, për komunën e Prizrenit ka pasur 10 ankesa në vitin 2013<sup>32</sup>, mirëpo për shkak të mungesës së bordit të OSHP-së shtatë nga këto ankesa nuk janë shqyrtuar. Ndërsa nga tre të shqyrtuara dy janë aprovuar ndërsa një është dërguar në ri-tenderim. Krahasuar me komunat e tjera, Komuna e Prizrenit radhitet në komunat me numër të madh të ankesave, së bashku me Gjilanin dhe Prishtinën.

## PRAKTIKAT E MIRA

Publikimi i njoftimeve në ueb faqen e Komunës, madje edhe për kuotim të çmimeve në masë të madhe, është një praktikë shumë e mirë të cilën e aplikon komuna e Prizrenit. Shumica e Komunave të tjera në Kosovë, nuk publikojnë kuotimin e çmimeve dhe kjo është një indikator që duhet vlerësuar në Komunën e Prizrenit. Kjo mundëson sidomos bizneseve të vogla qasje në tenderët me vlera nën 10.000 euro. Ligji nuk kërkon që këto njoftime të publikohen në ueb faqen e KRPP-së dhe publikimi i tyre me vetë iniciativë të komunës është praktikë e cila duhet të merret si shembull edhe nga autoritetet e tjera kontraktuese.

## TENDERI PËR MIRËMBAJTJEN E RRUGËVE

Komuna e Prizrenit, ka zgjedhur tre kompani private për mirëmbajtjen e rrugëve, shesheve dhe trotuareve. Ky tender ka qenë i ndarë në tre lloje dhe ka pasur vetëm tre kompani të cilat kanë tenderuar. Vlera e këtij tenderi është rreth 56,000.00 euro.<sup>33</sup> Kompanitë të cilat kanë aplikuar për këtë tender janë Ekoregjioni, Shërbimi dhe Is-Company. Kontrata është e lidhur për një periudhë prej 36 muajve dhe është kontratë e tipit kornizë, që do të thotë se vlera totale e kontratës përcaktohet nga numri i punëve në terren, andaj shuma mund të jetë më e ulët apo më e lartë, varësisht nga volumi i punëve në terren. Kontratat për mirëmbajtjen e rrugëve janë mjaftë të favorshme për kompanitë, pasi që u sigurojnë qëndrueshmëri në financim. Interes të jashtëzakonshëm zgjojnë rrugët nacionale dhe rajonale, mirëpo edhe rrugët brenda qyteteve janë profitabile për kompanitë.

Është për t'u habitur fakti se në Komunën e Prizrenit ka pasur interesim të vogël të kompanive për të ofertuar. Vetëm kompanitë që kanë fituar në këtë tender kanë aplikuar. Asnjë kompani tjetër nuk ka paraqitur ofertë. Në anën tjetër dosjen e tenderit e kanë tërhequr pesë kompani, dy prej të cilave fare nuk kanë paraqitur ofertë. Për shkak të shpërblimit me kontratë të tre operatorëve aplikues, asnjëri nga ta nuk është ankuar në OSHP.

<sup>32</sup>Raporti i OSHP për vitin 2013, faqe 20

<sup>33</sup>Njoftimi për dhënie të kontratës numër 622 12 3171

|||||



|||||

aplikuar në këtë tender, me çmime në atë formë që janë shumë profitabile për kompanitë. Mirëpo edhe nëse kjo ka ndodhur pa dijen e autoritetit kontraktues, sapo të ketë filluar shqyrtimi i ofertave dhe leximi i çmimeve diçka e tillë do të duhej të evidentohej dhe kjo procedure tenderuese të anulohet për t'u rishpallur. Pasi që kjo nuk ka ndodhur, atëherë rrjedhimisht mund të kuptohet se autoriteti kontraktues është pajtuar me këtë situatë.

Nga qasja në ofertat e kompanive konkurruese, kemi vërejtur se ato kanë ofruar çmime të ndryshme për punët e njëjta varësisht nga llotet.<sup>35</sup> Kjo ka ndodhur për t'u siguruar që secila kompani do të fitoj vetëm nga një llot. Në të kundërtën do të ishte e pamundur që rastësisht çmimet të harmonizohen në të gjitha kategoritë në atë mënyrë. Kjo praktikë e fiksimit të çmimeve është e ndaluar në prokurim publik, pasi që është në kundërshtim me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik.

Mungesa e konkurrencës është po ashtu indikator tjetër se diçka nuk ka qenë në rregull me këtë tender, pasi që për tre lloje apo pjesë të tenderit ka pasur vetëm tre kompani. Në mesatare kjo i bie një kompani për një llot. Megjithatë secila prej tyre ka paraqitur ofertë për të tri llotet, çmimet kanë pasur dallime minimale në atë formë që secila prej tyre të marr njërin nga pjesët e kontratës.

Problemi i tretë i këtij tenderi, që lidhet prapë me çmimet është forma se si janë kalkuluar këto çmime. Në pjesën e parë të kontratës, çmimet janë mujore, përderisa në pjesë tjera çmimet janë në orë pune. Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve nëpër qytet paguhet me çmimin e caktuar në kontratë në muaj dhe nuk specifikohet numri i intervenimeve që duhet të bëjë kompania.

Në përgjithësi në këtë kontratë mund të konstatohen fiksime të çmimeve nga operatorët ekonomik, konkurrencë e vogël apo mungesë e konkurrencës së ndershme dhe çmime relativisht të larta krahasuar me punët që duhet të kryhen.

## TENDERI PËR FURNIZIM ME NAFTAË

Komuna e Prizrenit sikurse edhe disa komuna të tjera të Kosovës, karburantet i paguan më shtrenjtë sesa çmimet e tregut. Përderisa në pompat për shitje me pakicë të karburanteve, nafta mund të blihet nga 1.15 euro, deri në 1.21 euro<sup>36</sup>, Komuna e Prizrenit këtë artikull e ka paguar me 1.26 euro. Kjo e dhënë është vërejtur nga KDI në kuadër të monitorimit të prokurimit publik për komunën e Prizrenit. Nga të dhënat e ofruara për pagesën e naftës nga komuna, shihet se ky artikull për muajin korrik është paguar për 1.26 euro.

Në anën tjetër kjo komunë ka edhe çmimin për premium ndër më të lartit që në kuadër të

<sup>35</sup> Komuna e Prizrenit ka ofruar qasje direkte në ofertat e operatorëve ekonomik, përkatësisht shikimin dhe analizimin e tyre në zyrat e Komunës, për shkak se të njëjtat sipas komunës ka qenë e pamundur të ofrohen në kopje fizike apo ekeltronike

<sup>36</sup> Çmimi i naftës për muajin korrik 2014

|||||



monitorimit kemi hasur. Komuna e Prizrenit paguan premiumin prej 0.15 euro, për kompaninë fituese të këtij tenderi.<sup>37</sup> Nëse e krahasojmë Komunën e Prizrenit me komunat më të vogla fqinje, vërehet se kjo komunë ka një kontratë shumë më të pa favorshme. Krahasuar me komunën e saj fqinje, shumë më të vogël për kah territorit dhe buxheti, atë të Mamushës, Prizreni paguan pesë centë më shtrenjtë litrin e naftës, pasi kjo komunë paguan 10 cent premiumin për naftë. Dallim edhe më i madh vërehet kur ky çmim krahasohet me komunën tjetër fqinje po ashtu shumë më të vogël sesa komuna e Prizrenit, atë të Shtimes. Kjo komunë ka dallim në Premium prej 13 centëve, pasi Komuna e Shtimes, paguan premiumin për naftë vetëm dy cent.<sup>38</sup> Po ashtu ky premium është në shpërputhje edhe me kontratën e AQP-së, e cila ka lidhur në emër të 37 institucioneve publike. AQP ka lidhur kontratë për furnizim me naftë me premiume të cilat sillen nga 1.5 cent, deri në 2.6 cent, varësisht nga lloji i naftës.<sup>39</sup>

Ngjashëm me komunat e tjera, kalkulimi i çmimit është ofruar të bëhet në çmimin e berzës së PLATTS. Mirëpo këtë berzë është kërkuar që ta siguroj kompania. Komuna e Prizrenit në këtë rast nuk ka të dhëna të çmimit të karburanteve në berëzat ndërkombëtare, për këtë do të bazohet në të dhënat të cilat i sjell kompania private e cila fiton tenderin. Mirëpo mbetet e pa njohur metoda se si do të vërtetojë komuna nëse këto çmime janë të vërteta ose jo, nëse nuk ka të dhëna të tjera për krahasim. Çmimi i berzës edhe pse sigurohet nga disa prej institucioneve të Kosovës, nuk ndahet me të gjitha organizatat buxhetore dhe autoritetet kontraktuese. Në këtë formë ato të vetmet të dhëna të disponueshme i kanë ato të cilat i sjellin kompanitë me të cilat kanë lidhur kontratat. Mirëpo në këtë formë, autoritetet kontraktuese janë shumë të ekspozuara ndaj rrezikut të mashtrimit nga këto kompani pasi që nuk kanë mundësi të vërtetojnë çmimet. Një bashkëpunim në mes KRPP, Doganës dhe AQP do t'i ndihmonte autoritet kontraktuese që të bëjnë pagesat në bazë të dhënave zyrtare dhe jo atyre që sjellin kompanitë.

Për këtë tender në Komunën e Prizrenit, ka pasur shumë pak interesim nga kompanitë që shesin karburante. Vetëm dy kompani kanë aplikuar në këtë tender, që janë njëkohësisht edhe kompanitë kryesore në garën për tender. Hib Petrol dhe Petrol Company, janë të vetmit operatorë që kanë dorëzuar ofertat për këtë tender. Kompania Petrol Company, ka ofertuar me premium prej 15 cent, përderisa Hib Petrol ka pasur ofertë akoma më të shtrenjtë 17 cent për liter. Që të dy operatorët në raportin e vlerësimit i kanë plotësuar të gjitha kushtet e dosjes së tenderit dhe kanë qenë të përgjegjshme në tender. Sidoqoftë mbetet i pa shpjegueshëm çmimi shumë i lartë i ofertave të këtyre dy kompanive të cilat krahasuar me ofertën që i kanë dhënë AQP-së në tenderin për furnizim me naftë, dallimet janë shumë fish më të larta. Në kontratat që ka sjell kompania fituese në ofertën e saj, në formë të referencave, shihet se institucioneve të tjera

<sup>37</sup>Njoftimi për dhënien e kontratës 622 13 401 111

<sup>38</sup>Njoftimi për dhënien e kontratës 617 2014 031 111

<sup>39</sup>Kontrata e AQP me Hib Petrol për furnizimin e 27 institucioneve me naftë dhe derivate, 15 shtator 2014

|||||

kjo kompani u ofron naftë me çmime shumë më të ulëta. Për shembull kjo kompani i shet produktet e naftës Bankës Procredit, me vetëm 0.02 euro premium. Në kontratën e vitit 2011, e njëjta kompani, komunës së Prizrenit i ka shitur produktet e njëjta me çmim prej 0.0001 euro premium për litër.

Sidoqoftë dallimi i çmimit të naftës, përkundër dallimit të çmimeve në premiume, është shqetësues për faktin se institucionet, si komuna e Prizrenit, e cila ka lidhur një kontratë kornizë tre vjeçare, po paguan naftën me çmim shumë më të lartë sesa çmimi i këtij produkti në tregun me pakicë dhe ky është një indikator shqetësues, pasi tregon efikasitet të dobët të prokurimit.

Gjatë monitorimit tonë kemi vërejtur se qasja në çmimin e berzës është shumë problematike, andaj edhe kemi bërë një krahasim shumë të thjeshtë për të dëshmuar mos përputhjen e të dhënave që dorëzojnë kompanitë private për institucionet e Kosovës. Ne për këtë mostër kemi krahasuar berzën e Komunës së Prizrenit, të cilën e ka sjell kompania Petrol Company dhe në anën tjetër kemi marr çmimin e berzës së kompanisë Graniti Petrol. Të dy kompanitë kanë sjell çmimet e berzës për muajin korrik, në mesataren e PLATTS. Ajo çfarë i dallon këto dy çmime të berzës është formati i kalkulimit të çmimit. Përderisa Petrol Company, ka kalkuluar çmimin në një format me 11 njësi, ku ka radhitur çmimet fillestare, taksat, akcizën, etj., kompania Graniti ka llogaritur çmimin në 15 njësi. Dallimi i dytë dhe shumë i rëndësishëm është çmimi i naftës pa premium. Në këtë rast, për shkak se të dy kompanitë kanë të njëjtën referencë PLATTS, çmimi është dashur të jetë i njëjtë, për shkak se i referohet mesatares mujore për muajin korrik. Sidoqoftë dallimi është në rreth katër centë. Në këtë rast kompania Graniti ka çmimin mesatar të naftës 1.14812 euro, përderisa Petrol Company çmimin pa Premium e ka 1.1092 euro. Po ashtu tek Petrol Company, çmimi i transportit të naftës nuk është i sqaruar, vetëm i referohet ngarkesës nga “Shërbimi Doganor i UNMIK-ut” dhe nuk sqaron ngarkesën monetare për transportin. Në anën tjetër kompania Graniti ngarkon institucionet me 1000 euro për maune me 30.000 litra.

Kjo e dhënë më së miri vë në dukje nevojën për kontratë të centralizuar për furnizim me karburante, për të shmangur çmimet e ndryshme që paguajnë organizatat buxhetore. Mirëpo përderisa kjo të ndodhë nga AQP, atëherë patjetër duhet që një institucion qendror publik të sigurojnë çmimin e karburanteve në mesatare për çdo muaj. Në këtë mënyrë buxhetit të shtetit mund t’i kursehen shumë para vetëm duke u koordinuar më mirë institucionet shtetërore dhe duke i ndarë informacionet.

KRPP, nuk e ka rregulluar çështjen e tenderimit të karburanteve dhe në këtë formë, nuk ka një standard se si institucionet e tenderojnë këtë produkt. Disa kërkojnë oferta fikse, disa çmime me Premium, disa te tjera çmime me Premium në të cilën llogaritet edhe çmimi i transportit etj. Konsiderojmë se fusha e tenderimit me naftë është pak a shumë kaotike për shkak të mungesës së rregulloreve dhe bazës ligjore përkatëse, për t’u furnizuar me këtë artikull, i cili në tregjet ndërkombëtare mund të ketë ulje apo ngritje në vazhdimësi. AQP përkundër përgjegjësisë ligjore

|||||

|||||

nuk ka lidhur kontratë të centralizuar për produktet e naftës, e cila do të ishte më e lehtë të mbikëqyrej dhe kontrollohej çmimi dhe cilësia nga institucionet mbikëqyrëse, si dhe do të fitohej në vlerë për paranë e shpenzuar.

Të gjitha të gjeturat në këtë kontratë për karburante të cilat janë vërejtur si çështje të ndjeshme tek nafta, vlejnë edhe për pjesën e furnizimit me benzinë, ku vlejnë i njëjti çmim i premiumit dhe janë të përcaktuara të njëjtat kushte të kontratës.

|||||









|||||

të kërkesave teknike, ofertuesit “Bejta Commerce” dhe “Bass Com” (fituesi) kishin paraqitur një pjesë të pajisjeve (eskavator) me të njëjtat dokumente të pronësisë. Në dosje të tenderit nuk kishte ndonjë dëshmi (marrëveshje) për shfrytëzim të këtyre pajisjeve. Përveç kësaj, një sërë dokumentesh tjera të këtyre ofertuesve ishin krejtësisht të njëjta. Autoriteti kontraktues nuk kishte ndërmarrë asnjë masë për t’i sqaruar këto çështje ndonëse kishte indikacione për bashkëveprim nga këta dy ofertues.

|||||





|||||

prej 0.0001 euro për litër, përderisa Compact Petrol ka pasur një çmim më të shtrenjtë për Premium, 0.05 euro për litër. Të dy operatorët në raportin e vlerësimit i kanë plotësuar të gjitha kushtet e dosjes së tenderit dhe kanë qenë të përgjegjshme. Por dallimi është shumë i madh i çmimeve të këtyre dy tenderëve prej 0.0499 euro premium. Kompania Compact Petrol është më e shtrenjte, andaj kompania Petrol Company ka fituar pasi edhe kriter për fitimin e këtij tenderi ka qenë çmimi më i lirë. Sidoqoftë është shumë e paqartë çmimi jo normalisht i ulët i ofertës së kompanisë fituese dhe vendimi i Komunës së Gjilanit që megjithatë të nënshkruaj kontratë me këtë operatorë.

KRPP nuk e ka të rregulluar çështjen e tenderimit të karburanteve dhe në këtë formë nuk e ka asnjë standard se si institucionet e tenderojnë këtë produkt. Disa kërkojnë edhe oferta fikse, disa çmime me premium, disa të tjera çmime me premium në të cilën llogaritet edhe çmimi i transportit etj. Konsiderojmë se fusha e tenderimit me naftë është pak a shumë kaotike për shkak të mungesës së rregulloreve dhe bazës ligjore përkatëse, për t'u furnizuar me këtë produkt i cili në tregjet ndërkombëtare mund të ketë ulje apo ngritje në vazhdimësi. AQP përkundër përgjegjësisë ligjore nuk ka lidhur kontrate të centralizuar për produktet e naftës, e cila do të ishte më e lehtë të mbikëqyrej dhe kontrollohej çmimi dhe cilësia nga institucionet mbikëqyrëse, si dhe do të fitohej në vlerë për parane e shpenzuar.

Është shumë e nevojshme që një institucion qendror publik të siguroj çmimin e karburanteve në mesatare mujore, për arsye që në këtë mënyrë edhe buxheti i shtetit mund të kursej shumë para vetëm duke u koordinuar më mirë institucionet shtetërore dhe duke i ndarë më mirë informacionet.

Të gjeturat në këtë kontratë për karburante të cilat janë vërejtur si çështje të ndjeshme tek nafta, vlejné edhe për pjesën e furnizimit me benzinë, por pasi që me naftë shpenzohet katër fish më shumë sesa benzina, në këtë komunë, jemi fokusuar më shumë tek çështjet e naftës.

|||||



||||| tjetër komuna e Gjakovës ka paguar çmime shumë më të larta për këtë artikull, përkatësisht me 16 dhe 18 euro për M<sup>2</sup>. Ky çmim i kontraktuar nga Komuna e Gjilanit, nuk i garanton cilësi dhe as kryerje të punimeve në afatin e paraparë me planin dinamik, sidoqoftë në këto raste i rekomandohet Komunës që t'i kushtojë vëmendje të posaçme mbikëqyrjes së punimeve në cilësi dhe afat kohorë dhe në rast të problemeve të shqiptohen gjobat e parapara deri në konfiskim të sigurisë së ekzekutimit të tenderit. Për më tepër Komuna e Gjilanit aktualisht nuk ka të angazhuar kompani profesionale për mbikëqyrjen e punimeve dhe këtë i duhet ta bëjë me stafin e vet, kështu do ta ketë dyfish më të vështirë të përcjell kryerjen e suksesshme të punëve dhe monitorimin e kontratave.

Ndërkohë që edhe në këtë tender vlen të thuhet se dosja e tenderit e hartuar nga komuna, ka qenë shumë më precize sesa komunat e tjera të cilat janë monitoruar. Përmes kësaj dosje kompanive u është minimizuar mundësia e mashtrimit përmes çmimeve për njësi. Çështja e vetme që nuk ka funksionuar edhe në këtë rast është çmimi jo normalisht i ulët, të cilin zyrtarët e prokurimit dhe njësia e kërkesës në këtë rast drejtoria përkatëse, kanë mundur shumë lehtë ta dinë se ky çmim nuk u garanton se kontraktori do të bëjë punë kualitative dhe çmimet nuk janë në përputhje me tregun.

## **KONTRATË PËR FURNIZIMIN ME NAFTË PËR NGROHJE PËR TË GJITHA NJËSITË SHPENZUESE TË KOMUNËS SË GJILANIT**

Kjo është edhe kontrata e tretë e cila është analizuar në këtë raport. Komuna e Gjilanit ka lidhur dy kontrata, për të njëjtin artikull, me të njëjtin operatorë ekonomik dhe për më tepër me të njëjtin çmim.<sup>48</sup> Kontrata për furnizim me naftë për ngrohje për të gjitha njësitë shpenzuese të Gjilanit u lidh me 10 tetor 2014 e cila do të distribuohet sipas porosive nga Autoriteti Kontraktues si: Drejtorati i Arsimit, QKMF-ja, Zyra e Kryetarit dhe drejtoritë e tjera shpenzuese të kësaj komune. Në këtë njoftim për kontrate kanë ofertuar tre ofertues ku të tre ofertuesit ishin të përgjegjshëm. Ofertuesit e kësaj kontrate ishin “Petrol Company” nga Prishtina, “HIB Petrol” nga Ferizaj dhe “Flamuri” nga Suhareka. Si edhe në kontratat e lartpërmendura, ashtu edhe kjo kontratë si kriter për dhënien e kontratës ishte çmimi më i ulët. Fitues i kësaj kontrate ishte përsëri “Petrol Company” me një çmim të premiumit 0,0001 euro për litër. Sasia e përafërt është 160.000 litra me një kohë të shpërndarjes deri në fund të muajit maj 2015.

Për dallim nga kontrata për furnizim me derivate për vetura dhe gjeneratorë, sasia e së cilës ndahej në naftë dhe benzinë, edhe pse pjesa më e madhe e shpërndarjes së furnizimit ishte me naftë, këtu në këtë kontratë e gjithë sasia e shpërndarjes do të bëhet me naftë. Edhe këtu është

<sup>48</sup>Njoftimi për dhënien e kontratës me numër GI 651 14 063 121



|||||

Tabela 1. Vlerat Fikse dhe Variabile.		
Data- 30.11.2014	NENTOR / 2014	Vërejtje!
Lloji I Derivatit	EURO DIESEL	
Kursi mesatar mujor I dollarit	0.8018\$=1.2472	
Pesha specifike variabile në Kg/Litër (1,000 Kg=1,1910 L )	Litra 1.1910	25 Tx1.191L= 29,775L
Çmimi mesatar mujor I Euro Dieselit në Dollar/Ton.	\$736.76	
Akciza e Euro Dieselit për Ton.	€ 360.00/T	0.360 euro/litër
Transporti për maune nga Dogana,rruga Shqipëri-Maqedoni-Kosove	500.00 Euro	
Premiumi I rafinerise vlera shtesë nga Çmimi mesatar botëror për T	\$49.00	
Premiumi I operatorit fitues,I shprehur ne euro për litër	0.000 euro	

Tabela 2.Përlllogaritja e Çmimit kushtues për euro/diesel.

Përlllogaritja	Vlerat monetare	Njësia	Statuti	Përshkrimi
A	0.73676	/kg	Variabil	Çmimi CIF i Platts-it.
B	\$ 0.0490	/kg	Fiks	Premiumi I rafinerisë mbi Platts.
C=A+B	0.78576	/kg	-	CIF Platts+Premiumi I rafinerisë.
D	1.2472	-	Variabil	Çmimi mesatr mujor I S/€ .
E=C/D	0.63002	/kg	-	Çmimi pa transport.
F=E/1.191	€ 0.5290	/liter		Çmimi për Kg I konvertuar në Lit.
G	€ 0.0168		Fiks	Transporti € 500/29,775 L
G1	€ -		Fiks	Taksa rrugore 100€/Maune.
H=F+G+G1	€ 0.5458			Çmimi bazë pa shërbimet doganore
J	€ 0.3600	/liter	Fiks	Akciza 0.36 euro/litër.
K=H+J	€ 0.9058			Çmimi bazë për kalkulim pa TVSH
L=K*16%	0.1449		Fiks	Tvsh-ja për litër.
N=K+L	1.0507	/liter		Çmimi total pa Premium
P	0.0000	/liter	Fiks	Premiumi i operatorit për litër
O=N+P	1.0507	/liter		Çmimi kushtues

## TENDERI PËR MIRËMBAJTJE DIMËRORE TË RRUGËVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË GJILANIT

Komuna e Gjilanit me datë 23.02.2015 lidhi kontratë pune me Kompaninë Zuka Comerc sh.p.k nga Gjilani, njëkohësisht edhe fituese e tenderit për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në territorin e Komunës së Gjilanit. Përmes kësaj kontrate Komuna ka kontraktuar pastrimin e rrugëve nga bora dhe akulli. Tenderi është i ndarë në dy pjesë, në atë të mirëmbajtjes së rrugëve në qytet ku do të pastrohen të gjitha rrugët e qytetit me fshatrat dhe rruga me asfalt dhe në anën tjetër mirëmbajtja e rrugëve rurale ku do të pastrohen fshatrat dhe lagjet rrugët me zhavorr. Çmimi për pjesën e parë është 35,111.00 euro dhe çmimi për pjesën e dytë është 23,900.00 euro. Vlera e përgjithshme e këtij tenderi është 59,011 euro.<sup>50</sup> Në këtë tender janë analizuar dosja e tenderit, paramasa dhe paralogaria, kontrata e kompanisë fituese dhe raporti i vlerësimit të tenderëve të cilat kanë ofertuar.

<sup>50</sup>Njoftimi për dhënie e kontratës me numër GI 651 111 43521

|||||



|||||  
 pavlefshme pasi kishte bërë kërkesë për qasjen në dokumente apo të ndonjë fature në Komunën e Novobërdës dhe asnjë nga këto nuk u është dëshmuar. Por në këtë rast ankesa u refuzua nga OSHP, pasi që sipas panelit shqyrtues të gjithë operatorët ekonomik të cilit kishin ofertuar kanë qenë të përgjegjshëm.

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve	Çmimi për njësi për Lot I	Çmimi për njësi për Lot II
Furnizimi me rërë, ngarkimi, transportimi dhe shpërndarja	3 euro m <sup>3</sup>	5 euro m <sup>3</sup>
Koha e kujdestarisë për 24 ore	20 euro ditë	35 euro ditë
Ngarkuesi	30 euro orë	5 euro orë
Graderi/ Makina Niveluese	30 euro orë	50 euro orë

Edhe pse i njëjti operator Zuka Commerce fitoi tenderin në të dyja pjesët, nga kjo tabelë vërehet një dallim i madh në çmime tek pjesa për mirëmbajtje të rrugëve dimërore në zonat e qytetit dhe ajo në zonat rurale. Tek pjesa e mirëmbajtjes së rrugëve në qytet te furnizimi me rërë, ngarkimi, transportimi dhe shpërndarja çmimin për njësi e ka tre euro për m<sup>3</sup>, kurse tek pjesa e dytë e mirëmbajtjes së rrugëve në zonat rurale çmimi është pesë euro për m<sup>3</sup> për njësi. Këtu vërehet qartë se në pjesën e dytë është dallimi për dy euro për m<sup>3</sup> për njësi, respektivisht 40%, më i shtrenjtë. Në anën tjetër është edhe kalkulimi i çmimit të kohës mesatare të kujdestarisë për 24 orë që vlen vetëm për një kamion tek pjesa e parë është 20 euro për ditë ndërsa tek pjesa e dytë koha e kujdestarisë për 24 orë e cila vlen vetëm për një automjet paguhet me 35 euro për ditë. Diferenca në mes të lloteve është 42.8%, që është një dallim shumë e madh.

Gjithashtu, dallimet tjera ishin edhe tek mënyra e kalkulimit të graderit/makinës niveluese dhe ngarkuesit. Graderi/makina niveluese për njësi në pjesën e parë llogaritet me 30 euro për orë, kurse te pjesa e dytë, graderi/makina niveluese llogaritet me çmim pesë (5) euro për orë për njësi. Këtu ka një diferencë shumë të madhe në çmim pasi që në pjesën e parë tek rrugët në qytet paguhet me një çmim është 25 euro për orë, respektivisht një dallim prej 80% në çmimin për njësi. Gjithashtu edhe ngarkuesi paguhet në pjesën e parë të tenderit me 30 euro për orë për njësi ndërsa në pjesën e dytë për 20 euro, apo 40%, më shtrenjtë që do të thotë 50 euro për orë për









|||||

derivateve, janë vetëm disa raste që përshkruajnë dështimin e kontrolleve. Kontratat që kanë kaluar nëpërmjet procedurave të prokurimit për vitin 2013 kapin një vlerë prej 7,138,454□

Auditori ka analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në PIP dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu, ka rishikuar edhe ndryshimin e projekteve të parapara gjatë vitit. Vlerësimet janë se sistemi i PIP si një sistem për menaxhimin e investimeve kapitale, nuk ishte përdorë në mënyrën e duhur. Disa kontrata për vitin 2013 nuk ishin të parapara me PIP. Raste të tilla janë me kontratën “Ndërtimi i parkut memorial në fshatin Meje” në vlerë 1,060,774□ dhe “Ndërtimi i rrugës në fshatin Skivjan” në vlerë 800,000□ Për këto kontrata, në sistemin e PIP-it nuk ishte planifikuar buxhet për vitet e ardhshme (2014 dhe 2015). Te kontrata me numër të prokurimit 014 “Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Çarshinë e madhe në Gjakovë” me vlerë 219,945□ ne nuk e kemi testuar këtë lëndë për arsye se ishte marrur për hetime nga departamenti i krimeve të rënda në Gjakovë.

Tek projekti “Rrethimi i oborrit dhe ndërtimi i terrenit sportiv në gjimnaz” me vlerë 77,222□ komisioni vlerësues kishte ndërhyrë në specifikacionin e ofruar nga kompania fituese te pozicioni numër 9 te kolona e çmimit. Operatori ekonomik kishte ofruar çmimin prej 1□ ndërsa komisioni vlerësues e ka korigjuar në 1,134□ Sipas Ligjit për prokurim publik (LPP), korigjimi i çmimeve nga komisioni vlerësues nuk është i lejuar.

Te kontrata “Furnizim me pjesë rezervë dhe riparimi i automjeteve zyrtare” me vlerë prej 132,678□ njëri nga kriteret e vendosura në dosjen e tenderit ishte që operatori ekonomik të ketë së paku dy referenca të natyrës së njëjtë. Ne kemi konstatuar se në dosjen e kompanisë fituese mungojnë këto referenca.

Në drejtoratin e administratës së përgjithshme nuk ka zyrtarë përgjegjës (logjistikë) që merret me mbajtjen e evidencave për shpenzimet e derivateve dhe servisimet për automjetet e komunës. Ne nuk na është ofruar në mënyrë analitike vlera e shpenzuar për servisim dhe vlera e shpenzuar e derivate për secilin automjet. Sipas drejtorisë së financave dhe raportit të freebalancit, shpenzimet për servise dhe mirëmbajtje për vitin 2013 ishin 31,333□ dhe për derivate 158,117□ Komuna, gjithashtu, nuk mban evidenca lidhur me fletudhëtimet mbi kilometrat e kaluara, me çka do të konfirmohet norma e shpenzimeve të derivateve dhe nëse automjetet janë përdorë për qëllime zyrtare.

Praktika të njëjta ishin edhe në Qendra Kryesore për Mjekësi Familjare (QKMF). Ekziston një kontratë për “Riparimin dhe mirëmbajtjen e veturave zyrtare” por që nuk dihet se cilët ishin artikujt e servisimit dhe për cilat automjete. Po ashtu, rast i ngjashëm ishte edhe me furnizimin me goma të automjeteve në QKMF. Sipas deklaratës së zyrtarit përgjegjës për menaxhim me vetura në QKMF gjatë vitit 2012 dhe 2013 ishin furnizuar me 36 goma të përdorura, ndërkaq pagesa ishte bërë për goma të reja. Sipas pohimeve të zyrtarit për menaxhimin e autoparkut në

|||||

QKMF, kjo kishte ndodhur me urdhërin e Drejtorit të shëndetësisë. Veprimi si i tillë ngrit dyshime për pagesa të parregullta si dhe përmban elemente të mashtrimit.

Tek të gjitha kontratat e rishikuara tek projektet kapitale ne kemi vërejtur se deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve nuk është nënshkruar nga ZKF, siç kërkohet me LPP. Tek kontratat Ndërtimi i AMF-së në Fshatin Novosellë e Ulët me vlerë prej 38,607□ dhe Ndërtimi i AMF-së në Ramoc me vlerë 40,026□ kemi vërejtur që zotimi i mjeteve për këto kontrata për vitin 2013 është bërë nga 5,000□ për secilën kontratë. Po ashtu, te këto kontrata, sigurimi i ekzekutimit në dosjen e tenderit ishte kërkuar të jetë 10% e vlerës së kontratës, ndërsa operatori ekonomik kishte dorëzuar sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 500□ Raste të njëjta ishin edhe te kontratat “Ndërtimi i rrugës në fshatin Damjan” në vlerë 470,102□ “Ndërtimi me asfalt i rrugës në fshatin Gërçin” me vlerë 338,433□ “Ndërtimi i parkut memorial në fshatin Meje” me vlerë prej 1,060,774□ “Ndërtimi me asfalt i rrugës Rogove-Ujz” me vlerë prej 234,763□

## PRAKTIKAT E MIRA

Publikimi i njoftimeve në ueb faqen e Komunës, madje edhe për kuotim të çmimeve, është një praktikë shumë e mirë të cilën e bën Komuna e Gjakovës. Shumica e komunave të tjera në Kosovë, nuk publikojnë kuotimin e çmimeve. Kjo është një indikator që duhet vlerësuar, pasi që i mundëson sidomos bizneseve të vogla qasje në tenderët me vlera nën 10.000 euro. Ligji nuk kërkon që këto njoftime të publikohen në ueb faqen e KRPP-së dhe publikimi i tyre me vetë iniciativë të komunës është praktikë e cila duhet të merret si shembull edhe nga autoritetet e tjera kontraktuese.

Komuna e Gjakovës është e para që ka adoptuar platformë të veçantë në internet në të cilën publikon të dhëna lidhur me fituesit e tenderëve. Në këtë platformë publiku mund të mësojë se cilat janë kompanitë të cilat kanë fituar më së shumti nga tenderët e komunës. Kjo praktikë duhet përcjell edhe nga komunat e tjera.

## KONTRATA PËR FURNIZIM ME NAFTË

Në Komunën e Gjakovës, në tenderin për furnizim vjetor me derivate të naftës, fitues është kompania NPT D&Z nga Gjakova.<sup>57</sup> Kjo kompani ka qenë në konkurrencë me operatorin më të madh Petrol Kompani. Në këtë tender konkurrenca ka qenë minimale, vetëm minimumi ligjor prej dy ofertave është plotësuar. Megjithatë ky tender është përcjellë me disa probleme të cilat janë evidentuar nga monitorimi ynë. Në këtë tender kalkulimi i çmimit të litrit të naftës, dosja e tenderit për poentimin e kompanive dhe kualiteti i naftës nuk është përcaktuar me kontratë.

<sup>57</sup>Njoftimi për dhënie të kontratës me numër 632 13 048 111

|||||

Nga praktikat e gjertanishme të monitorimit kemi vërejtur se komunat e Kosovës, naftën e paguajnë duke u bazuar në çmimet që kompania sjell nga çmimi i naftës në berëz. Zakonisht ky çmim merret nga PLATTS, kompani kjo e specializuar dhe mirënjohur për çmimet e naftës në tregjet ndërkombëtare. Sidoqoftë KDI ka pasur vërejtje për këtë formë të kalkulimit të çmimit, pasi që e njëjta nuk është bërë nga institucioni por nga kompania. Në çdo rast kur mungon mbikëqyrja dhe kontrolli ka hapësirë që çmimet të mos kalkuloohen drejtë dhe ekziston rrezik për ngritjen e çmimeve. Në Komunën e Gjakovës, çmimi kalkulohet në një formë tjetër. Në këtë rast kompania sjell faturën me të cilën është furnizuar me naftën me shumicë dhe në këtë faturë i llogaritet premiumi. Ky është një problem shumë i madh, për shkak se kompania e kontraktuar naftën në treg mund ta blej me çmime shumë të larta krahasuar me ato të berzës ndërkombëtare dhe prapëseprapë komuna është e obliguar që të bëjë pagesën mbi këtë bazë.

Kështu krahasuar me çmimin e naftës për muajin korrik, për të cilën kemi siguruar faturat e pagesës Komuna e Gjakovës, çmimin e shumicës për naftë, pa llogaritur premiumin e paguan më së shtrenjti. Gjakova naftën për litër pa premium e paguan 1.19 euro (kjo nënkupton çmimin e naftës në tregun me shumicë) këtij çmimi pastaj i shtohet premiumi prej 0.04 euro. Rrjedhimisht kjo e bën çmimin për një litër naftë 1.23 euro.<sup>58</sup> Në anën tjetër çmimi me shumicë i naftës dallon tek kompanitë e tjera të cilat sigurojnë bursën nga PLATTS. Për shembull kompania “Graniti Petrol” çmimin e naftës për litër pa premium e kalkulon 1.14 euro, ndërsa kompania tjetër “Petrol Company” çmimin e naftës për të njëjtin muaj e kalkulon 1.11 euro.<sup>59</sup> Rrjedhimisht vërehet se vlera e premiumit në kontratat e naftës nuk është i vetmi indikatorë matës se cili do të jetë çmimi përfundimtar i litrit për naftë. Në fakt komuna e Gjakovës në këtë rast është dëmtuar nga forma se si ka kalkuluar çmimin për rreth dyfishin e premiumit që paguan për një litër naftë.

Problemi i kalkulimit të çmimit të naftës nga komuna në komunë vërehet se është problem i cili po ndikon që komunat të humbin në vlerën për para dhe konkurrenca në këtë sektorë të mos jetë e barabartë. Për më tepër kontribut të jashtëzakonshëm në këtë situatë kanë dhënë edhe institucionet qendrore të prokurimit publik të cilat nuk kanë përcaktuar formë të detajuar të tenderimit të naftës përmes nxjerrjes së një rregullore dhe duke mos u dhënë qasje komunave në çmimin e naftës në berëzat ndërkombëtare.

Komunat në të gjitha rastet kanë hapësirë të tepërt për të dizajnuar dosjen e tenderit, formën e vlerësimit dhe formën e faturimit të çmimit. Rrjedhimisht shumica e komunave të Kosovës paguajnë artikullin me çmim më të lartë sesa vlera në treg. Kur kësaj i shtohet fakti se komunat shpenzojnë qindra mijëra euro në këtë artikull për ngrohje dhe vetura, ky çmim është i pa arsyeshëm. Në çdo rast që komuna paguan një artikull me çmim më të lartë sesa vlera e tij në treg, kjo përbën dështim të prokurimit dhe humbje të arsyes për të ekzistuar kontrata me operatorë

<sup>58</sup> Çmimi i naftës për muajin korrik 2014

<sup>59</sup> Çmimi është krahasuar duke u bazuar në të dhënat që kompanitë kanë dorëzuar për muajin korrik 2014

|||||



|||||

shumë domethënës dhe më së mirë e tregon rrjedhën e tenderit në fjalë.

Në praktikën e prokurimit publik në Kosovë, të gjithë tenderët për kontrata të punëve shpallen për projektet e caktuara. Në këtë formë lidhet nga një kontratë për secilin projekt dhe rrjedhimisht lejohet konkurrencë në këtë sektorë. Komuna e Gjakovës për një vit i ka dhënë monopol kompanisë “Beni” që ta shtroj secilën rrugë që kërkohet me kubëza të betonit. Kjo lloj kontrate kornizë, pa pasur projekte të veçanta, është lidhur për të përmbushur nevojat e kreut komunal, në mënyrë që të realizoj sa më shpejt dhe lehtë punët në teren, në raste të fushatave elektorale. Në këtë mënyrë Kryetari i Komunës mund të shtroj me kubëza të betonit cilën do rrugë, pa pasur nevojë për tender të veçantë. Kjo tregon se në këtë kohë komuna ka funksionuar pa projekte të planifikuara dhe punët janë kryer sipas nevojave politike dhe jo planeve zhvillimore.

Të gjitha paramasat e projektit janë me numër një, që do të thotë se nuk dihen paramasat e vërteta dhe nevojat e komunës, se sa do të shpenzohen kubëza, me çfarë trashësie dhe sa artikuj të tjerë për ndërtimin e rrugëve, artikuj të cilët janë periferik. Operatorit i është lënë hapësirë shumë e madhe që të manipuloj me çmimet për njësi. Në këtë formë çmimet e kubëzave janë shumë të larta, përkatësisht 18 euro për M<sup>2</sup> tek kubëzat me trashësi 6.0 centimetër (CM), ndërsa kubëzat e trashësisë 8.0 cm çmimi është 14 euro.<sup>61</sup> Dosja e tenderit ka edhe rreth 30 pozicione të tjerat të cilat janë ofertuar në të shumtën e rasteve me çmime minimale 0.10 euro ose 0.20 euro. Kjo tregon se operatori ekonomik ka planifikuar që të gjitha rrugët t’i shtroj me kubëza të trashësisë 6.0 cm dhe në këtë formë ta ngarkojë sa më shumë financiarisht komunën përmes kësaj kontrate.

Në krahasim me dy komunat paraprake të monitoruara, Mamushën dhe Prizrenin, të cilat çmimin për kubëza betoni e kanë pasur 5.6 dhe 8 euro, Gjakova paguan çmime shumë më të larta. Duke rritur çmimet tej mase në pozicione të caktuara, ku operatori e dinë se shpenzohen sasi të mëdha të artikullit, siç është rasti i kubëzave në këtë tender, çmimi përfundimtarë i projektit mund të dal shumë më i shtrenjtë sesa që duket në ofertën e operatorit. Kjo ndodh për shkak se kubëza në këto raste harxhohen shumë fish më shumë sesa të gjithë artikujt e tjerë së bashku, ku kompania ka ofertuar me 0.10 apo 0.20 euro. Kjo do të thotë se tek çmimet për njësi në kontratat kornizë, konkurrenca nuk është e drejtë dhe e ndershme, pasi që oferta më e lirë, në fakt mund të jetë më e shtrenjtë.

Komisioni i përzgjedhur nga komuna, ka rekomanduar që të anulohet procedura e tenderit për shkak të çmimeve të cilat janë në shpërputhje me ato të tregut.<sup>62</sup> Sidoqoftë komisioni ka vlerësuar se çmimet janë shumë të ulëta, duke e anashkaluar çmimet e larta në disa prej kategorive në të cilat më së shumti do të shpenzohet nga komuna. Nga hartimi i gabuar i dosjes së tenderit, me ose pa qëllim, i ka dhënë hapësirë operatorëve ekonomik që të ofertojnë në atë mënyrë që

<sup>61</sup>Kontrata e Komunës së Gjakovës me operatorin ekonomik Beni

<sup>62</sup>Raporti i vlerësimit të tenderëve, me numër 632 13 003 511

|||||



|||||

çmimet për njësi të mos jenë domosdoshmërisht çmimet më të lira në çmimin total të kontratës. Në këtë formë përveç dëmtimit të buxhetit të komunës, operatorët e tillë e dëmtojnë edhe konkurrencën e ndershme.

Operatori ekonomik Beni është ankuar në OSHP për këtë anulim të tenderit dhe ka fituar rastin, duke urdhëruar kështu komunën që të nënshkruaj kontratën me këtë operator, përkundër që çmimit ishin të dëmshme.<sup>63</sup> Një operatorë i cili në të gjitha pozicionet ka vendosur çmimet reale të tenderit, në këtë rast do të ishte shumë më i shtrenjtë në ofertë, për shkak të formës së poentimit. Në dosjen e tenderit është dashur të parashihen sasi të artikujve, në mënyrë që çmimet e ekzagjeruar në kategoritë të cilat shpenzohen më shumë, do të reflektonin në çmimin e përgjithshëm të ofertës. Kjo për shkak se nuk ka kuptim që pusetat dhe kubëzat të jenë më numrin e njëjtë të sasisë. Në një rrugë ku bëhet shtrimi me kubëza ka mesatarisht 5 deri në 10 puseta varësisht nga gjatësia e rrugës. Në anën tjetër sasia e kubëzave të shpenzuara është shumë më e madhe dhe kjo gjithsesi duhet të reflektoj në para masat e dosjes së tenderit.

---

<sup>63</sup>Ankesa e Operatorit Ekonomik Benin ë OSHP, me numër 65/13











# KOMUNA E MAMUSHËS





|||||

kontratës për 36 muaj është 100,000.00 euro.

Karakteristikë e veçantë e kësaj procedure është se nuk ka pasur interesim të kompanive të mëdha për të marr pjesë në këtë tender. Sido që të jetë, Kompania Flamuri, kalkulimin e çmimit për naftën e bën nga dokumentet e kompanisë Hib-Petrol<sup>72</sup>, për çmimet e berzës së naftës, e cila kompani jep çmimet nga anëtarësimi në PLATTS.

## ÇËSHTJE TË IDENTIFIKUARA NË KONTRATË

Komuna e Mamushës, blen naftën me çmim më të shtrenjtë sesa çmimi me pakicë i këtij produkti në treg. Kompania e cila kalkulon çmimin e naftës Hib-Petrol, gjatë muajit qershor 2014, naftën e ka shitur në tregun me pakicë për 1.20 ose 1.21 euro. Komunës së Mamushës i është kalkuluar çmimi i naftës për 1.25 euro.<sup>73</sup> Çmimi i naftës me shumicë, siç është rasti me këtë komunë, vlera e kontratës 100,000.00 euro, nuk ka shpjegim se si mundë të kushtoj më shtrenjtë sesa çmimi me pakicë. Këtë çështje e ka mundësuar forma e kalkulimit të çmimit dhe forma që kanë zgjedhur institucionet, pasi që kompanitë konkurrojnë me premium (fitime) dhe në anën tjetër institucionet nuk kanë qasje në çmimet e berzës.

Ngritjes së çmimit të naftës për Komunën e Mamushës, i ka kontribuar edhe çmimi i fryrë i transportit, i cili për një maune 30,000 litra, kalkulohet me 3000 euro.<sup>74</sup> Në anën tjetër kompanitë e tjera të njëjtin shërbim e kalkulojnë nga 500 – 1000 euro. Në KRPP pranojnë se çështja e kontratave për furnizimin me naftë është e parregulluar sa duhet me akte nënligjore, pasi mungojnë rregullat dhe udhëzimet e nevojshme. Kjo në anën tjetër ka hapur rrugë që institucionet dhe bizneset të kenë shumë hapësire për të rritur vlerën e kontratave të kësaj natyre. Institucionet punojnë me çmime të berzës së naftës përkundër që nuk kanë qasje në berzë dhe u besojnë çmimeve që sjellin kompanitë private.<sup>75</sup>

Një kompani tjetër me të cilën kemi krahasuar çmimet e naftës, “Graniti Petrol” i cili gjithashtu merr disa tender nëpër komuna, kalkulon çmimin e naftës për transport me 1000 euro për 30,000 litra. Sasia e njëjtë e naftës dhe i njëjti shërbim, institucioneve u kalkulohet me çmime thellësisht të ndryshme. Problemi themelor me çmimin e transportit të naftës, është se nuk është pjesë e vlerësimit të ofertave. Çmimi sado i lartë që të aplikohet për transportin e naftës nuk e dëmton kompaninë dhe nuk i zvogëlon shanset për të fituar kontratën. Në anën tjetër premiumi mund të jetë më i vogël ose i arsyeshëm, mirëpo prapë se prapë çmimi i naftës të jetë i shtrenjtë krahasuar

<sup>72</sup> Nga qasja në dokumente zyrtare kemi vërejtur se operatori Flamuri është shërbyer me dokumentet e kompanisë Hib Petrol, të cilat i janë adresuar MPMS-së

<sup>73</sup> Fatura e pagesës së çmimit të naftës për muajin qershor 2014, Komuna e Mamushës për kompaninë Flamuri

<sup>74</sup> Fatura e pagesës së naftës për muajin qershor 2014, bashkë me çmime mesatar mujor berzës PLATSS

<sup>75</sup> Intervistë personale me Avdyll Limani, Departamenti i Rregullave në KRPP, data 08.10.2014

|||||





|||||

## FORMA E KALKULIMIT TË ÇMIMIT PËR KOMUNËN E MAMUSHËS

Berëza e çmimit të naftës, përfshin taksat e aplikueshme në Kosovë, çmimin e transportit dhe premiumin. Ky dokument është kompanisë Hib Petrol, i cili i adresohet MPMS-së



**HIB PETROL**

Ferizaj - Kosovë

Drejtuar : **MPMS**

Lënda : Kalkulimi i Qmimit Për Periudhën Qershor 2014  
Mesatarja e PLATTS ( CIF Med Genova/Lavera )

### POLIC OF KOSOVA AND HIB PETROL

#### CONVERSION RATES / RAPORTI

Diesel	1 liter	=	0.838 kg
Diesel	1 kg	=	1.1933 litra

#### EXCISE / AKCIZA

diesel	€ 0.310 per liter	=	€ 310.00 per 1000 litra
--------	-------------------	---	-------------------------

Average Platts CIF price for month:	Qershor 2014
Çmimi mesatar i Platts-it per muajin:	\$ 929.45

Exchange rate EUR/USD	
for period: Qershor 2014	
€ 1	= \$ 1.3592
\$ 1	= € 0.7357

#### CALCULATION OF THE PRICE BASED ON FIXED AND THE VARIABLE COMPONENT

		Njesia/Unit	Description/Explanation of price components
A	\$ 0.9295	/kg	Platts CIF price
B	\$ 0.0420	/kg	(Refinery's cost is the average (47\$ + CIF)
C=A+B	\$ 0.9715	/kg	CIF Platts + the Refinery's cost
D	1.3592		EUR/USD exchange rate for month of:
E=C/D	€ 0.7147	/kg	(includes Platts price + cost of purchase from the
F	€ 0.5989	/liter	(por purpose of calculating the customs charges)
G	€ 0.0330		EUR 3000 is charged per truck for imports from
G1	€ 0.0031		bank account based on the UNMIK Regulation
H=F+G+G1	€ 0.6350		Base price for calculating the customs charges
I=H*7%	€ -		
J	€ 0.3600	/liter	Excise
K=H+I+J	€ 0.9950		Subtotal (basis for calculating the VAT)
L=K*15%	€ 0.1592		VAT at 16%
N=K+L	1.1542	/liter	without the premium.
P	0.1		Premium
	1.2542		Qmimi Total Për Faturim Qershor 2014

|||||



|||||

paramasë është përshkruar i kategorisë IV dhe V që është tereni më i vështirë i gjurmimit, ndërsa kompania ka ofertuar me 0.10 për M<sup>2</sup>. Shtruarja e kubëzave me trashësi 8cm është ofertuar me 5,65 euro, çmim ky dukshëm më i ulët sesa ai i tregut, pasi të njëjtat kushtojnë nga 10 euro deri në 13. Po ashtu edhe pastrimi i terrenit në metër gjatësi është shumë i ulët, përkatësisht 0,14 euro për m<sup>2</sup>.<sup>77</sup> Komuna e Mamushës po që se ka marrë kualitetin e duhur të punëve dhe ka pasur para masat reale në dosjen e tenderit, ka përfituar një kontratë shumë të volitshme me këtë operator. Zakonisht kontratat e lira rezultojnë me vonesa dhe kualitet të ulët të punimeve, që shtojnë edhe nevojën për mbikëqyrje më rigorozë nga ana e menaxherëve të kontratës dhe komisionit për pranimin teknik të punëve. Në llogaritje totale të çmimeve për njësi për 4000 m<sup>2</sup>, komuna ka përfituar në 8.63 euro çmim për 1 m<sup>2</sup>.

## PJESA II. PARAMASA DHE PARALLOGARIA

NR. I ART.	PËRSHKRIMI	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI €	TOTALI €
1.	Matjet gjeodezike, vendosja e shenjave kontrolluese stabile përgjatë rrugës	m <sup>1</sup>	800.00	0,13	104 <sup>02</sup>
2.	Pastrimi i terrenit nga materialet e ngurta, drunjëve dhe zhvendosja e rrethojave në vendet ku parashihet sipas projektit	m <sup>1</sup>	800.00	0,14	112 <sup>02</sup>
3.	Gjurmimi i gjere i trupit të rrugës të kategorisë së IV-V, d=15 cm	m <sup>2</sup>	4,800.00	0,10	480 <sup>02</sup>
4.	Planifikimi dhe ngjeshja e sipërfaqes së bazamentit të rrugës deri të arrihet ngjeshja e kërkuar sipas përshkrimit teknik.	m <sup>2</sup>	4,800.00	0,10	480 <sup>02</sup>
5.	Furnizimi i materialit dhe montimi i skajorëve të betonit 8x20x100 cm të parapërgatitura, duke llogaritur edhe bazën nga betoni për shtangim dhe mbushjen e fugave.	m <sup>1</sup>	1,400.00	2,-	2,800 <sup>02</sup>
6.	Furnizimi i materialit dhe betonimi me beton MB 30 përkaj (anash) kubëzave në vendet ku nuk mund të vendosen skajorët.	m <sup>1</sup>	200.00	1,-	200 <sup>02</sup>
7.	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shtresës së tamponit 0-31.5 mm me trashësi d=15 cm (në gjendje të ngjeshur.)	m <sup>2</sup>	4,000.00	0,40	1,600 <sup>02</sup>
8.	Furnizimi dhe shtruarja e shtresës rrafshuese 4-8 mm me trashësi 3-5 cm nën kubëza si dhe mbulimi i fugave dhe pastrimi i kubëzave pas përfundimit të punimeve	m <sup>2</sup>	4,000.00	0,10	400 <sup>02</sup>
9.	Furnizimi dhe shtruarja në rrugë e kubëzave të betonit me trashësi 1-8 cm, si dhe mbulimi i fugave.	m <sup>2</sup>	4,000.00	5,65	22,600 <sup>02</sup>
10.	Punimi me zhavorr i bankinave në të dy anët e rrugës dhe ngjeshja sipas projektit.	m <sup>1</sup>	1,600.00	0,10	160 <sup>02</sup>
11.	Gjurmimi i dheut për kanalin e ujërave atmosferike në gjerësi dhe në thellësinë e nevojshme me projekt, nivelimi dhe planifikimi me pjerrtësi gjatësore sipas standardeve.	m <sup>1</sup>	300.00	0,50	150 <sup>02</sup>
12.	Furnizimi dhe vendosja e rërës nën, anash, dhe mbi gypat e betonit dhe kanalizimit.	m <sup>1</sup>	300.00	0,50	150 <sup>02</sup>
13.	Furnizimi dhe mbushja e kanalit me zhavorr fraksion 0-31.5 mm deri në nivelin e rrugës duke e ngjeshur në shtresa në pjesën ku kalon në rrugë.	m <sup>1</sup>	300.00	0,50	150 <sup>02</sup>
14.	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN4 Ø 315 mm për kolektorët kryesorë, planifikimi dhe nivelimi i kanalit duhet të jetë sipas standardeve.	m <sup>1</sup>	300.00	1,-	300 <sup>02</sup>

<sup>77</sup>Kontrata e Komunës së Mamushës me Kompaninë Flori, për shtrimin e rrugëve me kubëza të betonit, numër 626 14 010 521

|||||

## KONKLUZIONI

### **Kontrata për furnizim me naftë:**

Kontrata për furnizim me naftë dhe derivate të tjera të naftës është lidhur me një kompani që ofron naftën me çmim më të shtrenjtë sesa çmimi me pakicë i këtij produkti në treg;

Ngritjes së çmimit të naftës i ka kontribuar edhe çmimi i fryrë i transportit, i cili për një maunë 30,000 litra, kalkullohet me 3000 euro. Sasia e njëjtë e naftës dhe i njëjti shërbim, institucioneve u kalkullohet me çmime të ndryshme;

Komuna e Mamushës, ka lidhur kontratë me çmime jo normalisht të ulët për M<sup>2</sup> gjë e cila rrezikon që punët në teren të mos kryhen në mënyrë kualitative dhe në përputhje me kërkesat e komunës.

Book Title and info

|||||

**Katalogimi në botim – (CIP)**  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

<p><b>ISBN</b></p>
--------------------

|||||

